

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"VA.NI.CA. Holding" SHPK

Sot, më datë 10/03/2025, u paraqitën personalisht:

- **Z. David Ferrari**, i datëlindjes 08/04/1980, shtetas italian, lindur në Civita Castellana dhe banues në Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. AZ1764154.
- **Z. Erasmo Cipriani**, i datëlindjes 07/09/1955, shtetas italian, lindur në Roccagorga dhe banues në Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. CA62379QB.
- **Z. Fabio Petruskas**, i datëlindjes 30/06/1979, shtetas italian, lindur në Rome dhe banues në Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. CA85770TK.
- **Zj. Dorjana Kafeja**, e datëlindjes 16/05/1983, shtetase shqiptare, lindur në Memaliaj dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e letërnjoftimit me Nr. Personal 135516070E.

te cilet përpiluan këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **"VA.NI.CA. Holding" SH.P.K.** me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare **"VA.NI.CA. Holding"** SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **"VA.NI.CA. Holding"** SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.


NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **"VA.NI.CA. Holding"** SH.P.K dhe me emrin tregtar **VA.NI.CA. Holding**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë



Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Punime dhe shërbime me material porosites (Fason). Hekurosje, lavanderi dhe të tjera shërbime të ngjashme. Te veproje në operatione të përpunimit aktiv. Prodhim të veshjeve të ndryshme, tekstile si dhe eksport të tyre. Import - Eksport, përpunim aktiv, fasoneri etj.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rr. **Pjeter Bogdani**, Pallati 8/1, ZK. 8270, Nr. **Pas. 2/22+1-3**, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 (njëqind mijë lekë)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 4.

NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " **VA.NI.CA. Holding** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	David Ferrari
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	32,00 %
Lloji i kontributit:	Në para
Vlera e kontributit	32,000 (tridhjetë e dy mijë) lekë

Ortaku themelues :	Erasm Cipriani
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	32,00 %
Lloji i kontributit:	Në para
Vlera e kontributit	32,000 (tridhjetë e dy mijë) lekë



Ortaku themelues : **Fabio Petrauskas**
Numri i kuotave : **1**
Numri i pjeseve : **1**
Pjesemarrja ne Shoqeri : **35,00 %**
Lloji i kontributit: **Në para**
Vlera e kontributit **35,000 (tridhjetë e pesëmijë) lekë**

Ortaku themelues : **Dorjana Kafeja**
Numri i kuotave : **1**
Numri i pjeseve : **1**
Pjesemarrja ne Shoqeri : **1,00 %**
Lloji i kontributit: **Në para**
Vlera e kontributit **1,000 (një mijë) lekë**

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas regjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.



NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

- **Z. Fabio Petrauskas**, i datëlindjes 30/06/1979, shtetas italian, lindur në Roccagorga dhe banues ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. CA85770TK.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit u hartua në gjuhën shqipe dhe iu përkthye e lexua në gjuhën italiane nga **Zj. Dorjana Kafeja** për Ortakët Themelues, të cilët nuk e zotërojnë gjuhën shqipe. Pasi u shqyrtua, dokumenti u konsiderua në përputhje me vullnetin e tyre dhe u nënshkrua pa asnjë vërejtje.


ORTAKET THEMELUES

Z. David Ferrari


Z. Erasmo Cipriani

Z. Fabio Petrauskas

Zj. Dorjana

DAVID FERRARI



ERASMO CIPRIANI

Kafeja

FABIO PETRAUSKAS

Dorjana Kafeja
